



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2019:132373

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06505388

P.nr.116/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me bashkëpunëtorin profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurit E.A. nga Vushtrria për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr.90/09, të dt.27.08.2010, më datën 25.11.2024 jashtë seancës, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.nr.90/09, të dt.27.08.2010 kundër të pandehurit E.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par.1 të KPK-së, për shkak të mosmarrjes në pyetje të të pandehurit në fazën hetimore (neni 149 par.1 i KPPK-së).

II. URDHËROHET – Konfiskimi i përhershëm i armës – revole TT e prodhimit rus, cal.7.62 mm, pa numër serik.

II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.nr.90/09, të dt.27.08.2010 kundër të pandehurit E.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par.1 të KPK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i ka dërguar thirrje për plotësimin e parashtresës Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, pasi që nga shqyrtimi i aktakuzës dhe shkresave të lëndës ka vërejtur se i pandehuri nuk është marrë në pyetje në procedurë paraprake ashtu siç përcaktohet në nenin 149 par.1 të KPK-së.

Prokurori i shtetit nuk ka bërë plotësimin e aktakuzës brenda afatit të caktuar nga gjykata.

Gjykata me aktvendimin P.nr.140/16, datë 05.12.2023 ka hedhur aktakuzën Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.nr.90/09, të dt.27.08.2010 kundër të pandehurit E.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par.1 të KPK-së. për shkak të mosplotësimit të të njëjtës, konform nenit 441 par.4 të KPPK-së.

Kundër aktvendimit P.nr.140/16, datë 05.12.2023, të kësaj gjykate ankesë ka paraqitur Prokuroria Themelore Mitrovicë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë, ka nxjerr aktvendimin PN.ND.nr.56/24, të datës 26.01.2024 me të cilin ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore Mitrovicë dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Në riprocedurë, kjo gjykatë, bazuar në shkresat e lëndës, dispozitat ligjore në fuqi dhe praktikën e ndërtuar gjyqësore në raste të ngjashme ka ardhur në përfundim se aktakuza është e jashtëligjshme dhe se e njëjta duhet të hedhet.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, Prokuroria Themelore Mitrovicë, ka ngritur E.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par.1 të KPK-së, për të cilën veprë sipas kodi penal parashihet dënimi me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000,00) euro ose dënimi me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vite.

Me nenin 5 par.1 të KPPK-së është paraparë se *“Çdo person i dyshuar ose të akuzuar i garantohet gjykim i drejtë dhe i paanshëm.”*

Me nenin 9 par.1 të KPPK-së është paraparë se *“Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.”*, ndërsa me par.2 është paraparë se *“I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t’i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t’i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t’i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.”*

Me nenit 99 par.1 të KPPK-së është përcaktuar se *“Kur policia apo ndonjë agjenci tjetër qeveritare bën kallëzim tek prokurori i shtetit për dyshim të arsyeshëm për veprë penale, prokurori i shtetit mund të fillojë fazën e hetimit të procedurës penale sipas nenit 100 të këtij Kodi.”*

Me nenin 149 par.1 të KPPK-së ku është përcaktuar se *“Përveç rasteve të parapara në nenin 234, paragrafi 2 të këtij Kodi, i pandehuri duhet të merret në pyetje nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri hetohet për veprë apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i*

*paraparë është deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari apo i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit.”*

Me nenin 101 par.1 të KPPK-së është përcaktuar se *“Qëllimi i hetimit është që të mblidhen provat dhe të dhënat e nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngritet aktakuza apo të pushohet procedura dhe për të mbledhur prova të cilat mund të jetë e pamundshme apo e vështirë që të riprodhohen në shqyrtim gjyqësor.”*

Me nenin 234 par.2 të KPPK-së është përcaktuar se *“Në rastet kur i pandehuri është në arrati ose për shkaqe tjera është i paarritshëm për organet e ndjekjes, prokurori i shtetit mund të ngrisë aktakuzë edhe nëse i pandehuri nuk është marrë në pyetje në procedurë paraprake apo nuk ka dhënë deklaratë në procedurë paraprake. Aktakuza nga ky paragraf ngritet pasi të jenë shterur të gjitha përpjekjet për ta gjetur të pandehurin nga nenet 172, 173, 534 dhe 535 të këtij Kodi.”*

Sipas vlerësimit të gjykatës, bazuar në dispozitat e mësipërme, prokurori i shtetit nuk ka mundur të ngrit aktakuzën duke pasur parasysh se i pandehuri, në rastin konkret akuzohet për veprë penale për të cilën parashihet dënimi me burgim me më shumë se tri (3) vite, dhe se në këto raste prokurori i shtetit duhet të zbatoj hetimeve dhe se i pandehuri duhet të merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake.

Poashtu sipas vlerësimit të gjykatës, zbatimi i hetimeve dhe marrja e deklaratës së të pandehurit në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraparë është detyrim i prokurorit të shtetit kur bëhet fjalë për vepra penale për të cilat parashihet dënimi me burgim me më shumë se tri vite, ndërsa marrja në pyetje duhet të bëhet në procedurë paraprake, para ngritjes së aktakuzës.

Gjykata tutje vlerëson se për vepra penale të natyrës së tillë (për të cilat parashihet dënimi me burgim me mbi tri (3) vite), zbatimi i hetimeve dhe marrja në pyetje e të pandehurit në seancën e marrjes së deklaratës konsiderohen veprime procedurale të detyrueshme, pavarësisht faktit që i pandehuri ka pasur të drejtë që edhe të mbrohet në heshtje. Megjithatë, e rëndësishme dhe e domosdoshme, është dhënia e mundësisë së të pandehurit që të paraqes mbrojtjen e tij, duke i ofruar mundësinë që edhe të njihet me rezultatet e veprimeve hetimore, si dhe me mundësinë e kundërshtimit të provave gjatë fazës së hetimeve, ndërsa, të gjitha këto veprime procedurale, bazuar në dispozitat ligjore të theksuara më lart, është dashur që të ndërmerren para se të ngritet aktakuza.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se mos marrja në pyetje të të pandehurit gjatë seancës së marrjes së deklaratës është në kundërshtim të plotë me parimet kryesore të procedurës penale dhe atë parimin e kontradiktoritetit dhe parimin e barazisë së armëve, dhe në këtë mënyrë, të pandehurit i është pamundësuar e drejta që të njihet me rezultatet e hetimeve dhe i janë mohuar të drejtat e mbrojtjes, parime dhe të drejta këto që burojnë edhe nga neni 6 i KEDNJ-së, që lidhet me “E drejta për një proces të rregullt”.

GJEDNJ ka vënë në pah se qëllimi kryesor i nenit 6 të KEDNJ-së (“E drejta për një proces të rregullt”), është që të sigurojë një gjykim të drejtë nga një "gjykatë" kompetente për të përcaktuar

"çdo akuzë penale" dhe kjo nënkupton që garancitë nga neni i lartcekur aplikohen edhe në procedurën paraprake. (rasti: "*Imbrioscia kundër Zvicrës*", nr.13972/88, Aktgjykimi i datës 24.11.1993; rasti "*Salduz kundër Turqisë*", nr.36391/02, Aktgjykimi i datës 27.11.2008, paragrafi 50; rasti: "*Brennan kundër Mbretërisë së Bashkuar*", nr.39846/98, Aktgjykimi i datës 16.10.2001, paragrafi 45, etj.). Kështu, neni i lartcekur, e sidomos paragrafi 3 i këtij është me rëndësi jetike të zbatohet duke përfshirë edhe procedurën paraprake, para se një çështje penale të dërgohet për gjykim në mënyrë që procesi penal të mos paragjykohej seriozisht për shkak të dështimeve fillestare për të respektuar dispozitat nga ky nen.

GJEDNJ, poashtu, në disa raste tjera nga jurisprudenca e saj ka sqaruar se një ndër lehtësitë që duhet të gëzojë çdo i pandehur është mundësia për t'u njohur, me qëllim të përgatitjes së mbrojtjes së tij, dhe rezultateve të hetimeve të zhvilluara gjatë të gjithë procedurës (rasti: "*Huseyn dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit*", nr. 35485/05, 45553/05, 35680/05 dhe 36085/05, Aktgjykimi i datës 26.10.2011; rasti "*Foucher kundër Francës*", nr.22209/93, Aktgjykimi i datës 18.03.1997, paragrafët 31-38, etj.). Përtej këtij aspekti, parimi i barazisë së palëve është një prej elementeve të pandashme nga nocioni i procesit të rregullt. GJEDNJ ka ritheksuar se sipas parimit të barazisë së armëve, si një nga tiparet e konceptit më të gjerë të një gjykimi të drejtë, secilës palë duhet t'i ofrohet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në një situatë të pafavorshme në raport me palën tjetër (rasti "*Foucher kundër Francës*", nr.22209/93, Aktgjykimi i datës 18.03.1997, paragrafi 34; rasti "*Bulut kundër Austrisë*", nr.17358/90, Aktgjykimi i datës 22.02.1996, paragrafi 47, etj.). Pra, kjo mbrojtje mund të përdoret edhe para dërgimit të rastit në gjykim, si edhe menjëherë sapo rregullsia e procesit rrezikon të cenohet rëndë nga mosrespektimi i kësaj dispozite, kurse mënyrat e realizimit të drejtës në mbrojtje gjatë fazës përpara procesit, për shembull gjatë hetimit paraprak, varen nga karakteristikat e procedurës dhe nga rrethanat e çështjes (rasti "*Brennan kundër Mbretërisë së Bashkuar*", nr.39846/98, Aktgjykimi i datës 16.10.2001, paragrafi 45; rasti "*Berliński kundër Polonisë*", nr.27715/95 dhe 30209/96, Aktgjykimi i datës 20.09.2002, paragrafi 75, etj.).

Sipas vlerësimit të gjykatës fakti se aktakuza është kthyer në plotësim pas caktimit të shqyrtimit fillestar dhe ndërmarrjes së veprimeve tjera, dhe jo pas pranimit të aktakuzës, nuk është fare relevant, pasi që siç u theksua edhe më lartë mos marrja në pyetje e të pandehurit në procedurë paraprake është pengesë e pakapërcyeshme për të proceduar me rastin, pasi që një gjendje e tillë mund të paragjykojë rëndë procedurën penale ndaj të pandehurit dhe se një procedim në një gjendje të tillë cenon rëndë dispozitat ligjore në fuqi, si dhe instrumentet ndërkombëtare me të cilat garantohet gjykimimi i drejtë dhe i paanshëm e të cilat instrumente zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, ashtu siç është vendosur edhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML.nr.343/2023, të datës 22.07.2024.

Konform nenit 60 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal, si ligj i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, i cili përcakton se "*Sendet të cilat janë përdorur apo janë dedikuar për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale mund të merren nëse janë pronë e kryerësit.*", është vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi lidhur me konfiskimin e armës.

Po ashtu, sipas vlerësimit të gjykatës, në rastin konkret, nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 234 par.2 të KPPK-së, në mënyrë që ngritët aktakuza edhe pa u marrë në pyetje i pandehuri apo pa marrjen e deklaratës së të pandehurit, pasi që në shkresat e lëndës nuk ka as edhe një provë të vetme e cila do t'a bindte gjykatën se në procedurën paraprake (hetimore), edhe për kundër zbatimit të neneve 172, 173, 441, 534 dhe 535 të KPPK-së marrja e deklaratës apo marrja ne pyetje e të pandehurit ka qenë e pamundur.

Andaj gjykata, mbi bazën e të lartcekurave vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal  
P.nr.116/24, datë 25.11.2024

Gjyqtar i vetëm gjykues  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.